

Shoqata “Drejtësi për Drejtësinë” kallëzon në SPAK komisioneren e vetingut



Shoqata “Drejtësi për Drejtësinë” ka kallëzuar në SPAK anëtarin e KPK-së Brunilda Bekteshin, për deklaram të rremë pasurie, bazuar në disa informacione të publikuar në disa portale.

Shoqata “Drejtësi për Drejtësinë” e krijuar nga gjyqtarë dhe prokurorë të shkarkuar nga Vetingu, drejtohet nga ish-prokurori Gentian Trenova.

Anëtarët e shoqatës mendojnë që vendimet për largimin e tyre nga sistemi janë të padrejta. Ata më 9 qershor i janë drejtuar Avokatit të Popullit që të verifikojë procedurën e përzgjedhjes dhe dokumentacionin, që kanë dorëzuar komisionerët e të dy shkallëve të Vettingut.

Sipas shoqatës, disa nga komisionerët e KPK dhe KPA nuk plotësojnë kriterin kryesor atë të përvojës së punës jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor i së drejtës, nëpunës i shërbimit civil në nivel drejtues ose në një përvojë të njohur në fushën e së drejtës administrative ose sfera të tjera të së drejtës.